

## 123 MATERIALET HARTOGRAFIKE – SHKALLA DHE KOORDINATAT

Fusha përmban të dhëna të koduara për shkallën dhe koordinatat, të cilat në formën e tekstit vendosen edhe në fushën 206. Fusha përsëritet kur njësia përmban material me shkallë dhe koordinata të ndryshme.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
123	Materialet hartografike – shkalla dhe koordinatat	r
<b>a</b>	<i>Lloji i shkallës</i>	nr
<b>b</b>	<i>Shkallë lineare horizontale me raport konstant</i>	r
<b>c</b>	<i>Shkallë lineare vertikale me raport konstant</i>	r
<b>d</b>	<i>Koordinatat – gjatësia gjeografike perëndimore</i>	nr
<b>e</b>	<i>Koordinatat – gjatësia gjeografike lindore</i>	nr
<b>f</b>	<i>Koordinatat – gjerësia gjeografike veriore</i>	nr
<b>g</b>	<i>Koordinatat – gjerësia gjeografike jugore</i>	nr
<b>h</b>	<i>Shkalla këndore</i>	r
<b>i</b>	<i>Pjerrësia - kufiri verior</i>	nr
<b>j</b>	<i>Pjerrësia - kufiri jugor</i>	nr
<b>k</b>	<i>Ngritja djathtas– kufijtë lindorë</i>	nr
<b>m</b>	<i>Ngritja djathtas– kufijtë perëndimorë</i>	nr
<b>n</b>	<i>Ekuioksi</i>	nr
<b>o</b>	<i>Epoka</i>	nr

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Shkalla</i></b>
	0	<i>Shkalla nuk është përcaktuar</i> (shih shembullin 5)
	1	<i>Një shkallë</i> (shih shembullin 1)
	2	<i>Disa shkallë</i> (shih shembujt 2, 3, 4, 6)
	3	<i>Varg shkallësh</i>
	4	<i>Shkalla e përafërt</i>
2		<b><i>Nuk është i përcaktuar</i></b>

Treguesi 1 tregon nëse në njësi është regjistruar një shkallë apo disa.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 123a Lloji i shkallës

Kodi tregon llojin e shkallës.

<b>a</b>	<i>shkallë lineare</i> Shkallë numerike, grafike dhe përshkruese.
<b>b</b>	<i>shkallë këndore (angulare)</i> Shih shembullin 5.
<b>z</b>	<i>lloj tjetër shkalle</i> P.sh. shkallë kodore, shkallë statistikore sasiore.

### 123b Shkallë lineare horizontale me raport konstant

Shkallë horizontale në formën e emëruesit të një thyese tipike. Përdoret për njësitë hartografike planetare dhe tokësore.

### 123c Shkallë lineare vertikale me raport konstant

Shkallë vertikale në formën e emëruesit të një thyese tipike. Përdoret për njësitë hartografike planetare dhe tokësore.

### 123d Koordinatat – gjatësia gjeografike perëndimore

### 123e Koordinatat – gjatësia gjeografike lindore

### 123f Koordinatat – gjerësia gjeografike veriore

### 123g Koordinatat – gjerësia gjeografike jugore

Koordinatat për njësitë planetare dhe tokësore vendosen në nënfushat d, e, f dhe g. Çdo nënfushë ka gjatësinë e përcaktuar prej 8 karaktereve dhe përmban këto të dhëna:

- hemisfera – një karakter ("w" = perëndim, "e" = lindje, "n" = veri, "s" = jug)
- gradë (tre karaktere numerike)
- minuta (dy karaktere numerike)
- sekonda (dy karaktere numerike)

Numrat barazohen në të djathtë, ndërsa në pozicionet e papërdorura vendosen zero.

---

## 123h Shkalla këndore

Shkalla këndore e hartave qiellore paraqitet në formë të një numri me 4 karaktere të barazuar në të djathtë, në pozicionet e papërdorura vendosen zero, duke e dhënë shkallën me milimetra.

---

## 123i Pjerrësia - kufiri verior

## 123j Pjerrësia - kufiri jugor

## 123k Ngritja djathtas– kufijtë lindorë

## 123m Ngritja djathtas– kufijtë perëndimorë

Në nënfushat i, j, k dhe m vëndosen koordinatat për njësitë hartografike qiellore. Nënfushat i dhe j kanë nga tetë karaktere dhe përmbajnë të dhëna të njëjta si nënfushat f dhe g, vetëm se në fillim shënohet simboli "+" (për hemisferën qiellore veriore) ose simboli "-" (për hemisferën qiellore jugore). Nënfushat k dhe m kanë nga gjashtë karaktere dhe përmbajnë këto të dhëna: orë, minuta, sekonda (secila nga dy karaktere numerike). Numrat barazohen në të djathtë, në pozicionet e papërdorura vendosen zero (shih shembullin 5).

---

## 123n Ekuinoksi

Ekuinoksi për njësitë hartografike qiellore jepet me vitin sipas kalendarit Gregorian. Numrat barazohen në të djathtë, ndërsa në pozicionet e papërdorura vendosen zero (shih shembullin 5).

---

## 123o Epoka

Epoka për njësitë hartografike qiellore jepet me vitin sipas kalendarit Gregorian. Numrat barazohen në të djathtë, ndërsa në pozicionet e papërdorura vendosen zero (shih shembullin 5).

# SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Kur shkalla nuk mund të përcaktohet, fusha përmban vetëm nënfushën a dhe koordinatat, nëse ato janë të pranishme në njësi.

Kur njësia përbëhet nga disa pjesë dhe ka disa shkallë horizontale dhe/ose vertikale, të gjitha shkallët vendosen në nënfushat të përsëritshme (shih shembujt 2, 6). Për tri ose më shumë shkallë mund të vendoset vargu i shkallëve në nënfushat b ose c; vlera më e vogël vendosen në nënfushën e parë, ndërsa në nënfushën e përsëritshme vlerën më të madhe.

Nëse koordinatat e hartës jepen për pikën qendrore dhe jo për skajet, vendoset dy herë gjatësia dhe gjerësia e boshtit qëndror, në nënfushat d dhe e (gjatësia) dhe nënfushat f dhe g (gjerësia). Në të njëjtën mënyrë veprohet kur pjerrësia dhe ngritja djathtas për hartat qiellore jepen bazuar në qendrën e hartës dhe jo në skajet e saj: pjerrësia vendoset në nënfushat i dhe j, ndërsa ngritja në nënfushat k dhe m.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 206 MATERIALET HARTOGRAFIKE – TË DHËNA MATEMATIKORE

Në fushën 206 vendoset shkalla dhe koordinatat në formën që e përshkruar në ISBD (CM).

## SHEMBUJ

### Hartat dhe globet:

1.

123	1□	<b>aa b253440 de0790000 ee0860000 fn0200000 gn0120000</b> (Hartë që përmban pjesë të Indisë e cila është 4 inç me një milje (1 : 253440) gjatësia 79° L me 86°; gjerësia 20° L me 12° V.)
-----	----	--

2.

123	2□	<b>aa b150000 b25000 de0150000 ee0173045 fn0013012 gs0023035</b> (Hartë e një pjese të Zairesë me shkallë lineare 1 : 150000 dhe 1 : 25000, gjatësia 15° L me 17°30'45 V; gjerësia 1°30'12 V me 2°30'35 J.)
-----	----	--

### Relieve:

3.

123	2□	<b>aa b744080 c96000 de1193000 ee1220000 fn0250000 gn0220000</b> (Hartë reliev e Tajvanit me shkallë horizontale 1 : 744080 dhe shkallë vertikale 1 : 96000; gjatësia 119°30' L me 122° L; gjerësia 25° V me 22° V.)
-----	----	---

4.

123	2□	<b>aa b90000 c10000 dw1120000 ew1090000 fn0600000 gn0490000</b> (Hartë reliev me pjesë të Alberta-s dhe Saskatchewan në Kanada me shkallë horizontale 1 : 90000 dhe shkallë vertikale 1 : 10000; gjatësia 109° P me 112° P; gjerësia 60° V me 49° V.)
-----	----	--

### Hartë qiellore:

5.

123	0□	<b>ab i-0160000 j-0490000 k163000 m193000 n1950 o1948</b> (Hartë qiellore me shkallë këndore, me pjerrësi -16° me -49°, ngritja djathtas nga 16 gradë 30 min në 19 gradë 30 min, ekuinoksi 1950, epoka 1948.)
-----	----	--

6. \*

123	2□	<b>aa b400000 b500000 b4000000</b> (Atlas që përmban harta në tri shkallë të ndryshme horizontale.)
-----	----	--